



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.2/2019

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi kryesues, Rrustem Thaqi dhe Adnan Konushevcu anëtarë, si dhe me pjesëmarrjen e zyrtares së lartë ligjore Valbona Millaku Foniqi, duke vendosur përkitazi me ankesën Institutit Demokratik të Kosovës (KDI) në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lista Serbe, për shkak të vendosjes së pllakatit në rrugë dhe në hapsirë publike, për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar të Komunave në Mitrovicën Veriore, Leposaviq, Zubin Potok, Zveçan, në seancën e panelit të mbajtur me 20.05.2019, mori këtë:

### V E N D I M

**Pranohet** si e bazuar ankesa e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI) në Prishtinë, ndërsa subjektit politik Lista Serbe, i shqiptohet dënimi më gjobë në vlerë prej 2000.00 (dymijë) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimi të këtij vendimi nën kërcënim të përmbarimit.

### A r s y e t i m

Me datën 17.05.2019, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) në Prishtinë, me të cilën pretendohet se me datë 16.05.2019, gjatë monitorimit të fushatës zgjedhore për zgjedhjet lokale të disa komunave të Kosovës, kanë verejtur një parregullsi të cilën e ka evidentuar edhe me fotografi. Sipas parashtresës të ankesës, në rrugët Knjaza Miloša, Lole Ribara, Krajla Petra, në pjesën e qendrës së qytetit të Mitrovicës së Veriut, monitoruesi i tyre ka hasur në pllakat me emër të subjektit politik Lista Serbe, të ngjitur në hapsira publike dhe atë në shtyllat e ndriçimit publik.

Me këtë rast parashtresë i ankesës thekson se është bërë shkelje e dispozitës së Nenit 33 paragrafi 1 pika b) i LZP-së, nga subjekti politik Lista Serbe në momentin që e ka vendosur pllakat me emrin e kandidatit në hapsirë publike.

Parashtresë i ankesës si provë ka bashkangjitur një fotografi të printuar, lidhur me rastin në fjalë.

PZAP-i, në kuptim të nenit 7 paragrafi 1 i Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it Nr.02/2015, me datë 17.05.2019, njoftoi subjektin politik Lista Serbe për ankesën e parashtuar, dhe ka kërkuar që të përgjigjet deri me datë 18.05.2019, në ora 16:00, mirëpo subjekti politik Lista Serbe nuk ofroi ndonjë përgjigje lidhur me këtë.

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

## **Ankesa është e bazuar**

Nga fotoja e ofruar si provë e cila gjendet në shkresat e lëndës shihet qartë se pllakati i kandidatit për kryetar komune së Mitrovices së Veriut nga radhët e subjektit politik Lista Serbe Goran Rakiq, është vendosur në rrugë dhe në hapsirë publike, veprim i cili është në kundërshtim me nenin 33 pika b) të LZP-së e cila përcakton: *“Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave, njoftimeve, dhe sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore në objekte dhe në rrugët publike.*

Duke u nisur nga arsyet e theksuara me lartë, Paneli konstaton se nga provat e ofruara shihet qartë se nga ana e subjektit politik Lista Serbe, është shkelur neni 33 pika (b) të LZP-së, pasi që posterit i kandidatit për kryetar të Komunës së Mitrovicës së Veriut, nga subjekti politik Lista Serbe, është i vendosur në vendin i cili nuk është i dedikuar për vendosjen e posterave.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura me fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat në rastin konkret, se subjekti politikë Lista Serbe, ka marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara që do të thotë se janë njoftuar me rregullat zgjedhore, dhe për kundër këtij fakti ka vendosur pllakat me emrin e kandidatit në rrugë publike. Poashtu Paneli si rrethanë mori edhe faktin se subjektit politik Lista Serbe ia dha mundësinë për tu përgjigjur në ankesë, por subjekti politik në fjalë nuk ofroi ndonjë përgjigje me të cilën do të dëshmonte se ka ndërmarr ndonjë veprim për të bërë përmisimin e shkeljes, e i cili veprim ka ndikuar në lartësin e gjobës së shqiptuar në dispozitiv të këtij vendimi

Paneli në kuptim të nenit 120.1 pika c), dhe nenit 118.1, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

Anr.2/2019 më datë 20.05.2019.

**Kryesuesi i Panelit**  
**Fejzullah Rexhepi**



**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.